LIGJ
Nr.9421, datë 29.9.2005

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR.1, DATË 11.9.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE), LIDHUR ME DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË VENDIT PRITËS PËR FORCAT PJESËMARRËSE NË STËRVITJEN "COOPERATIVE ENGAGEMENT 05" DHE ZHVILLIMIN E STËRVITJES USHTARAKE NDËRKOMBËTARE TË DREJTUAR NGA NATO, "COOPERATIVE ENGAGEMENT 05", ME PJESËMARRJEN E FORCAVE TË HUAJA USHTARAKE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 12, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 11.9.2005 të Këshillit të Ministrave "Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse në stërvitjen "Cooperative Engagement 05" dhe zhvillimin e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare të drejtuar nga NATO, "Cooperative Engagement 05", me pjesëmarrjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë".

Shpallur me dekretin nr.4670, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE), LIDHUR ME DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË VENDIT PRITËS PËR FORCAT PJESËMARRËSE PËR STËRVITJEN "COOPERATIVE ENGAGEMENT 05"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), këtu e në vazhdim të quajtura Palë,

duke mbajtur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të 4 prillit 1949, dhe në veçanti nenin 3, të zbatueshme për Palët në këtë Traktat;

duke pasur parasysh dispozitat e marrëveshjes mes palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO-SOFA) të 19 qershorit 1951;

duke pasur parasysh Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të kryetarëve të shteteve dhe qeverive, pjesëmarrëse në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokumenti Kuadër) të 10 janarit 1994;

duke pasur parasysh dispozitat e marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, lidhur me statusin e forcave të tyre (PfP SOFA) të 19 qershorit 1995;

duke pasur parasysh dispozitat e protokollit për statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit), të 28 gushtit 1952;

duke pasur parasysh dispozitat e protokollit tjetër shtesë të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, lidhur me

statusin e forcave të tyre (protokolli tjetër shtesë) të 19 dhjetorit 1997;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve të parashikuara të kryhen me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forca të tjera të NATO-s;

duke konsideruar se stërvitja Cooperative Engagement 05 (stërvitja) do të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, më 12 deri më 23 shtator 2005 dhe që vende të NATO-s dhe vende të PfP-së do të marrin pjesë në stërvitje;

duke konsideruar që Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë është një komandë strategjike në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, përgjegjëse për drejtimin e stërvitjes "Cooperative Engagement 05";

duke pasur në vëmendje dëshirën për procedura uniforme të zbatueshme për forcat pjesëmarrëse të vendeve të NATO-s dhe vendeve të PfP-së në drejtimin e stërvitjes;

duke njohur nevojat e pjesëmarrësve dhe të vendeve dërguese të mbështeten logjistikisht nga vendi pritës, me qëllim lehtësimin e stërvitjes,

kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm.

Neni 1

Përkufizime

Për qëllim të këtij memorandumi mirëkuptimi (MM), termat e mëposhtëm kanë kuptimet si u janë caktuar më poshtë:

1.1"Forca" - Nënkupton gjithë përbërësit e NATO-s, e forcës së NATO-s, duke përfshirë personelin, kafshët, materialet dhe dispozitat, së bashku me komponentët civilë të këtyre forcave, siç përcaktohet në NATO SOFA, PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe në protokollin tjetër shtesë të PfP SOFA-s. Ky term, gjithashtu përfshin gjithë anijet, avionët, automjetet, sistemet e komunikimit, depot, pajisjet, rezervat dhe municionin, si dhe burimet për lëvizjen ajrore dhe detare, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, përfshirë kontraktorët, të kërkuar për dislokimin ose mbështetjen e forcave.

1.2 "Komandanti i NATO-s"-Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandimit të NATO-s.

1.3 "Shtabet ndërkombëtare"- Shtabet ushtarake ndërkombëtare në strukturën e integruar të NATO-s. Përfshihen veprimtari që mund të jenë detashmente ose njësi të përkohshme të shtabeve.

1.4 "Shtabet kombëtare"- Shtabet ose forcat kombëtare në komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 "Shtabet shumëkombëshe" - Shtabet me personel nga më tepër se një komb, të formuara me marrëveshje të vendeve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.6 "Vendi pritës (VP)" - Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes.

1.7 "Mbështetja e vendit pritës (MVP)" - Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet, nga vendi pritës, forcave që janë të dislokuara në territorin, ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore të vendit pritës për qëllime të stërvitjes.

1.8 "Shpenzimet" - Shpenzimet që lidhen me mbështetjen dhe ruajtjen e shtabeve kombëtare, shumëkombëshe ose shtabet ndërkombëtare, forcat ose formacionet. Për qëllime të këtij memorandumi mirëkuptimi dhe dokumenteve që do ta pasojnë:

1.8.1 Shpenzimet e përbashkëta të NATO-s - Shpenzimet e pranuara më parë si përgjegjësi kolektive e Aleancës.

1.8.2 Shpenzime të ndara - Shpenzimet e pranuara më parë të jenë përgjegjësi e ndarë në më tepër se një shtet. Rregullimet për shpenzimet e ndara do të bazohen në një formulë të pranuar nga pjesëmarrësit.

1.8.3 Kosto kombëtare direkt - Shpenzimet e konsideruara të jenë përgjegjësi e një shteti të vetëm.

1.8.4 Fonde të përbashkëta të NATO-s - Fondet e siguruara nga vendet e NATO-s, përmes SHAPE-s për mbulimin e shpenzimeve të përbashkëta, që ndodhin gjatë drejtimit të kësaj stërvitjeje.

1.9 "Rajoni i stërvitjes" - Ky rajon përfshin zonën e trajnimit, së bashku me ujërat territoriale dhe të brendshme të Shqipërisë, siç përcaktohet në marrëveshjen teknike.

1.10 "Vende dërguese (VD)" - Vendet që dërgojnë forca jashtë territorit të vendit të tyre për të marrë pjesë në stërvitje.

1.11 "Marrëveshje teknike" - Marrëveshje në vazhdim të këtij memorandumi mirëkuptimi që do të zhvillojë dhe specifikojë procedurat dhe aspektet teknike për dispozitat e MVP-së.

1.12 "Klerancë e përgjithshme" - Do të thotë një kuadër i lejeve të kërkuara, në përputhje me legjislacionin e vendit pritës për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e forcave të vendeve dërguese për në/nga territori i vendit pritës dhe drejtimin e operacioneve për qëllim të drejtimit të stërvitjes, në përputhje me dispozitat e këtij memorandumi mirëkuptimi.

Neni 2
Qëllimi

2.1 Qëllimi i këtij memorandumi mirëkuptimi është të përcaktojë politikat dhe procedurat për dispozitat e MVP-së nga vendi pritës, forcës gjatë stërvitjes.

2.2 Ky memorandum mirëkuptimi dhe dokumentet që do ta pasojnë kanë si qëllim të shërbejnë si bazë për planifikimin nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe nga komandantët e NATO-s të MVP-së për stërvitjen.

Neni 3
Fushat dhe angazhimet e përgjithshme

3.1 Dispozitat e NATO SOFA-s, Protokollit të Parisit dhe PfP SOFA-s, si dhe të protokollit tjetër shtesë të PfP SOFA-s do të zbatohen për të gjitha operacionet mbështetëse të nevojshme për stërvitjen dhe të zbatueshme sipas këtij memorandumi mirëkuptimi.Vendi pritës njeh që vendndodhja operacionale dhe logjistike e vendosur për zbatimin e këtij memorandumi mirëkuptimi, janë detashmente të SHAPE-s dhe veprimtaritë e këtyre detashmenteve janë të ndërmarra nga SHAPE. Vendndodhja do të caktohet në dokumentet pasuese të këtij memorandumi mirëkuptimi. Rregullimet e komandë-kontrollit do të caktohen në planet e stërvitjes që do të zbatohen.

3.2 Ky memorandum mirëkuptimi do të jetë në përputhje me politikën dhe doktrinën e NATO-s (MC 334/1 dhe AJP 4.5) dhe siguron një mbrojtje dhe strukturë për MVP-në, për hyrjen e shpejtë të forcave e NATO-s dhe autorizimin e vendit pritës për dislokimin e forcës në territorin e vendit pritës dhe zbatimin efektiv të stërvitjes.

3.3. Ky memorandum mirëkuptimi parashikohet të jetë në harmoni me ligjet e vendit pritës dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që mund të zbatohen.

3.4. Pas miratimit të këtij memorandum mirëkuptimi midis SHAPE-s dhe vendit pritës, do të ftohen vendet dërguese të pranojnë dispozitat e këtij memorandumi mirëkuptimi përmes një njoftimi pranimi ose deklarate qëllimi.

3.5. Stërvitja, e mbështetur nga ky memorandum mirëkuptimi, do të kërkojë mbështetje logjistike shumëkombëshe për operacionet ajrore, përmes avionëve dhe helikopterëve me krahë të fiksuar dhe, në rast të porteve, përmes anijeve private ose ushtarake. Vendi pritës ka dijeni se lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në territorin shtetëror të vendit pritës, do të kryhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e operacionit. Vendi pritës do të kontrollojë të gjitha aspektet e kësaj lejeje në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4
Dokumente të zbatueshme

Dokumentet e zbatueshme për këtë memorandum mirëkuptimi janë përfshirë në aneksin A.

Neni 5
Përgjegjësitë

5.1 Vendi pritës

5.1.1 Vendi pritës jep pëlqimin për dislokimin dhe prezencën e forcës në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllim të stërvitjes dhe në vazhdim të stërvitjes.

5.1.2 Vendi pritës do të sigurojë mbështetje siç detajohet në dokumentet pasuese të këtij memorandumi mirëkuptimi. Mangësitë në madhësinë ose llojin e mbështetjes së parashikuar gjatë zbatimit praktik të mbështetjes së planifikuar do të identifikohen me bisedime.

5.1.3 Vendi pritës do të sigurojë mbështetjen e kërkuar logjistike dhe shërbimet siç është rënë dakord mes pjesëmarrësve të këtij memorandumi mirëkuptimi dhe siç është pranuar nga vendi pritës dhe vendet dërguese në marrëveshjet teknike, që mund të përfundohen për qëllim të vazhdimit të drejtimit të stërvitjes.

5.1.4 Në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e pranuar, vendi pritës do të lehtësojë procedurat e nevojshme me burime mbështetëse, duke përfshirë burime civile dhe tregtare.

5.1.5 Vendi pritës do të sigurojë vlerat e shpenzimeve 30 ditë përpara për shërbimet që do t'i sigurohen vendit pritës dhe vendi pritës do të mbajë të dhënat administrative e financiare të nevojshme për rimbursimin vendit pritës, të shërbimeve të siguruara për forcat. Të dhënat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxhetet e NATO-s do t'i jepen NATO-s kur kërkohen për qëllim kontrolli. Faturat duhet të përkthehen në gjuhën angleze.

5.1.6 Vendi pritës do të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda mundësive të tij për të lehtësuar lëvizjen e forcës në rrugë, hekurudhë, aeroport ose porte, së bashku me automjetet, anijet, avionët dhe pajisjet e forcës nga pika e hyrjes për në/dhe nga pritja, përqendrimi, dislokimi dhe rajonet e stërvitjes.

5.1.7 Vendi pritës do të autorizojë personelin e forcës të mbajë armë dhe municion gjatë stërvitjes në kohën dhe vendin siç do të përcaktohet midis vendit pritës dhe autoriteteve ushtarake të NATO-s dhe vendeve dërguese. Kjo do të jetë në përputhje me masat e mbrojtjes së forcës. Rregullimet e hollësishme për mbajtjen e armëve do të parashikohen në dokumentet pasuese të këtij memorandumi mirëkuptimi.

5.1.8 Vendi pritës do t'i sigurojë forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli ushtarak dhe lehtësirat e vendit pritës, në të njëjtat kushte si personelit ushtarak të vendit pritës.

5.1.9 Vendi pritës do ta njohë forcën me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rregullat lidhur me fushat e mëposhtme:

a) Mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e natyrës;

b) Shkatërrimi i produkteve të rrezikshme dhe municionit;

c) Llojet e armëve dhe rajonet e stërvitjes;

d) Procedurat në raste aksidentesh automobilistike;

e) Procedurat e rregullat e municioneve, përfshirë magazinimin dhe shkatërrimin;

1) Procedimi penal;

g) Rregullat dhe procedurat doganore;

h) Trafikun detar;

i) Trafikun ajror.

Ky informacion do të jepet të paktën 45 ditë përpara fillimit të stërvitjes. Gjithashtu, të paktën 45 ditë përpara fillimit të stërvitjes, vendi pritës do t'i sigurojë forcës një përmbledhje të historisë, zakoneve e traditave kulturore për aq sa ato lidhen me drejtimin e stërvitjes dhe forcën.

5.1.10 Vendi pritës do të sigurojë shërbime dhe mbështetje shtesë nga burimet tregtare vetëm kur kjo kërkohet nga autoritetet kompetente të NATO-s ose të vendeve dërguese.

5.2 SHAPE (ose komandanti i NATO-s):

5.2.1 Do të sigurojë, në maksimumin e mundshëm, që ky memorandum mirëkuptimi dhe dokumentet mbështetëse do të specifikojnë tipin, masën dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar për drejtimin e suksesshëm të stërvitjes dhe do të sigurojnë informacion shtesë të nevojshëm për planifikimin e vendit pritës, sa më shpejt të jetë e mundur.

5.2.2 Do të njoftojë në kohë për çdo ndryshim në rrethanat e vendit pritës dhe do të propozojë ndryshime të këtij memorandumi mirëkuptimi dhe dokumenteve mbështetëse, nëse nevojiten.

5.2.3 Do të identifikojë MVP-në e kërkuar dhe do të miratojë çmimet për shpenzimet e përbashkëta. Ne rast të kërkesave konfliktuese, prioritetet do të përcaktohen nga SHAPE ose komandanti i NATO-s.

5.2.4 Do të sigurojë rimbursimin financiar për vendin pritës për MVP-në e pranuar, nëse është paguar përmes financimit të përbashkët. Në të gjitha rastet e tjera, SHAPE ose komandanti i NATO-s do të ndihmojë aq sa është e mundur në zgjidhjen e detyrimeve financiare midis vendit pritës dhe vendeve dërguese.

5.2.5 Do të përcaktojë nëse financimi i përbashkët është i vlefshëm dhe cilat kërkesa janë të vlefshme për financimin e përbashkët.

5.2.6 Nëse kërkesat e vendeve dërguese janë në konflikt me prioritetet e shpërndarjes së burimeve të komandantit të NATO-s, do të zgjidhë konfliktin me vendet dërguese të përfshira.

5.2.7 Do të lehtësojë standardizimin e kërkesave të mbështetjes dhe shpenzimeve gjatë negociatave.

5.2.8 Do të drejtojë stërvitjen dhe do të përdorë lehtësirat e vendit pritës në përputhje me Rregullat Operacionale të Stërvitjes (EXOPORD) dhe dokumente dhe procedura të tjera të stërvitjes.

5.3 Vendet dërguese:

5.3.1 Do të respektojnë ligjet e vendit pritës në përputhje me nenin II të PfP SOFA-s dhe do të shmangin veprimet e papranueshme në kuadër të PfP SOFA-s, duke pasur parasysh kulturën, zakonet dhe traditat e popullsisë së vendit pritës.

5.3.2 Do të drejtojnë stërvitjen dhe do të përdorin lehtësitë e vendit pritës, në përputhje me

procedurat dhe dokumentet pasuese të stërvitjes.

5.3.3 Do të sigurojnë pajisjet e nevojshme teknike dhe operacionale për forcën, nëse nuk është siguruar nga ky memorandum mirëkuptimi dhe/ose ndonjë marrëveshje teknike.

5.3.4 Do të jenë përgjegjëse për kostot e të gjitha shërbimeve mjekësore dhe dentare civile të kryera nga vendi pritës.

5.3.5 Do të rimbursojnë vendin pritës për të gjitha shërbimet dhe mbështetjen e kërkuar dhe do të marrë, në përputhje me parimet e përkufizuara në seksionin 6 të këtij memorandumi mirëkuptimi.

5.3.6 Do të zbatojnë rregullat dhe procedurat mjedisore që janë në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit, si dhe ligjet shqiptare në lidhje me kërkesat mjedisore; humbjen e produkteve, koleksionin dhe lëvizjen; magazinimin, lëvizjen dhe shkatërrimin e materialeve të rrezikshme dhe municioneve për në, nga dhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Vendet dërguese do të vëzhgojnë të gjitha kufizimet lidhur me përdorimin e pasurive natyrore të mbrojtura.

5.3.7 Do të identifikojnë kërkesat e MVP-së vendit pritës dhe komandantit të NATO-s.

5.3.8 Do të raportojnë ndryshimet në kërkesat e MVP-së, të vendit pritës dhe komandantit të NATO-s, sapo ato ndodhin dhe do të paraqesin kërkesa të rishikuara të MVP-së.

5.3.9 Mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për MVP-në, përmes miratimit të këtij memorandumi mirëkuptimi ose duke nxjerrë një deklaratë qëllimi.

Neni 6
Çështje administrative

6.1 Hyrja dhe dalja e anëtarëve të forcës në dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë do të bëhet në përputhje me nenin 3 të NATO SOFA-s.

6.2 Importi dhe eksporti i pajisjeve dhe sasive të arsyeshme të rezervave ushqimore, pajisjeve dhe mallrave të tjera për përdorim ekskluziv të forcës brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të kryhet në përputhje me nenin 11 të NATO SOFA-s, rregullat shqiptare dhe procedurat doganore. Për import-eksportin e përkohshëm, NATO dhe vendet dërguese do të zbatojnë dokumentet doganore të siguruara nga vendi pritës.

6.3 Në përputhje me nenin 11 paragrafi 4 i NATO SOFA-s, sasitë e arsyeshme të mallrave, pajisjeve, rezervave ushqimore dhe mallrave të tjera për përdorim ekskluziv dhe konsumi të forcës në territorin e vendit pritës, do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe taksat, do të depozitojnë tek autoritetet doganore të vendit pritës një certifikatë të lëshuar dhe të nënshkruar nga personi i autorizuar i vendit dërgues që përmban specifikimin e mallrave dhe një përshkrim të përdorimit të tyre për nevoja të forcës.

Neni 7
Dispozita financiare

7.1 Shtabet e NATO-s, vendqëndrimet operacionale dhe forcat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e tyre, kur veprojnë për mbështetjen e stërvitjes, do të përjashtohen nga taksat dhe detyrimet në përputhje me nenin 11 të PfP SOFA-s dhe nenin 8 të Protokollit të Parisit.

7.2 Protokolli i Parisit, protokolli tjetër shtesë dhe ligji zakonor ndërkombëtar, i cili vendos imunitete dhe privilegje për shtabet e NATO-s, do të zbatohet për çdo shtab ndërkombëtar, elementet ose detashmentet e shtabeve që mund të dislokohen në vendin pritës për qëllim të stërvitjes.

7.3 Nëse nuk është i mundur përjashtimi i plotë nga taksat, detyrimet, tarifat dhe detyrime të tjera, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për Forcat e Armatosura të vendit pritës. Gjithë shpenzimet duhet të kryhen me vlerën më të vogël të kërkesave administrative shoqëruese.

7.4 Nëse komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë edhe të ligjshme, dhe të përballueshme për shpenzimet e përbashkëta të NATO-s (nga buxhetet e miratuara), SHAPE do të autorizojë financimin e përbashkët për këto shpenzime dhe do të caktojë komandantin e NATO-s, i cili ose do të paguajë drejtpërdrejt ose do të rimbursojë vendin pritës. Rimbursimi do të bëhet sipas kushteve të mëposhtme: 1. Komandanti i NATO-s ka pranuar paraprakisht kërkesën dhe çmimet e tij.

2. Vendi pritës ose shoqëritë tregtare sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm që produkti ose shërbimi në fakt iu është shpërndarë ose i është siguruar forcës.

7.5. Dokumentet pasuese të këtij memorandumi mirëkuptimi do të sigurojnë bazën kryesore për shpenzimet e vlerësuara dhe do të shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve ose si shpenzime të

përbashkëta të NATO-s (nëse është e zbatueshme), kosto të ndara ose shpenzime kombëtare të drejtpërdrejta.

7.6 Nëse disa shpenzime është parashikuar t'i atribuohen më tepër se një vendi, por nuk kualifikohen si shpenzime të përbashkëta të NATO-s, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të ndara dhe mund, që me marrëveshje të vendeve të përfshira, të ndahen në përputhje me një formulë për ndarjen e shpenzimeve të parashikuara në marrëveshjen teknike ose dokumente të tjera mbështetëse.

7.7 Vendet dërguese mund të prokurojnë mbështetje dhe shërbime me të njëjtat kushte siç i ofrohen Forcave të Armatosura të vendit pritës.

7.8 Detyrimet për materialet dhe shërbimet për personelin civil dhe ushtarak të siguruara nga vendi pritës nuk do të ngrihen në një shkallë më të lartë se për Forcat e Armatosura të vendit pritës dhe nuk do të përfshijë shpenzime shtesë administrative ose të larta, por mund të reflektojë rregullime për shkak të përjashtimit nga taksat, programeve të shpërndarjes, pikave të shpërndarjes ose elementeve të ngjashëm. Rimbursimi nuk do të paguhet për mbështetjen e siguruar nga personeli ushtarak.

7.9 Vendi pritës nuk do të shkaktojë ndonjë përgjegjësi financiare në emër të komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë më përpara nga një përfaqësues i autorizuar, dhe nëse nuk është pranuar përgjegjësia për pagimin e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk do të miratohet deri sa SHAPE ose vendet dërguese të miratojnë dokumentet mbështetëse dhe t'i zbatojnë drejtpërdrejt.

7.10 Financimi nuk jepet në lidhje me këtë memorandum mirëkuptimi dhe ky dokument nuk përfaqëson një detyrim specifik financimi në anën e komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese. Rregullime të veçanta financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse të këtij memorandumi mirëkuptimi.

7.11 Vendosja e zonave operacionale për të mbështetur një stërvitje, nuk do të përfshijë ndërtimin ose rehabilitimin e infrastrukturës.Vendi pritës nuk do t'i kërkojë komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese të paguajnë shpenzimet e rinovimit për lehtësirat e siguruara nga vendi pritës.

7.12 Mjetet e NATO-s dhe mjetet ushtarake të vendeve dërguese janë të siguruara dhe si të tilla, ato mund të veprojnë pa sigurim tregtar.

7.13 Rregullime financiare të detajuara dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet pasuese të këtij memorandumi mirëkuptimi.

Neni 8

Konsiderata ligjore

8.1 Juridiksioni do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e përfshira në nenin 7 të NATO SOFA-s.

8.2 Statusi i forcave të dislokuara në territorin e vendit pritës do të përcaktohet në përputhje me PfP SOFA-n, NATO-SOFA-n, Protokollin e Parisit dhe protokollin tjetër shtesë.

8.3 Pajisjet, furnizimet, prodhimet dhe materialet e importuara përkohësisht dhe të eksportuara nga territori i vendit pritës në lidhje me stërvitjen EX CE 05, janë të përjashtuara nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifat. Procedura të tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me PfP SOFA-n, NATO-SOFA-n, Protokollin e Parisit dhe protokollin tjetër shtesë.

8.4 Ankesat jokontraktuale që rrjedhin nga, ose në lidhje me zbatimin e këtij memorandumi mirëkuptimi dhe llojet e mbuluara nga neni 7 i NATO SOFA-s, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e nenit të lartpërmendur.

8.5 Ankesat kontraktuale do të shqyrtohen dhe zgjidhen nga vendi pritës, përmes procesit që drejton kontratat publike dhe në përputhje me ligjet e vendit pritës, me rimbursim nga komandanti i NATO-s ose vendet dërguese.

Neni 9

Mbrojtja e mjedisit

9.1 Vendi pritës do të sigurojë për të gjitha vendet, komandantët e NATO-s dhe komandat, rregullat mjedisore, të cilat do të zbatohen gjatë zhvillimit të stërvitjes. Standardet nuk do të jenë më të rrepta sesa ato të cilat veprojnë në të njëjtën kohë në Forcat e Armatosura të vendit pritës. Këto rregulla do të sigurohen 45 ditë përpara fillimit të stërvitjes. Me njoftimin e vendit pritës për standardet mjedisore, të

gjitha vendet do të veprojnë në përputhje me to gjatë stërvitjes. Dëmet e shkaktuara për shkak të mosrespektimit të standardeve të njoftuara do të kompensohen nga vendi që shkakton dëmin ose ankesat e mundshme do të zgjidhen në përputhje me nenin 8 të NATO SOFA-s.

Neni 10
Mbrojtja e forcës

10.1 Mbrojtja e forcës, e plotë dhe efektive, do të planifikohet për qëllim të kësaj stërvitjeje dhe do të detajohet në OPLANS, EXPI ose marrëveshjet shtesë. Mbrojtja e forcës do të zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në mënyrë të pajtueshme me NATO-PfP-SOFA-n. Mbrojtja e forcës, në asnjë mënyrë nuk do të kërkohet ose të sigurohet në kundërshtim me NATO/PfP/SOFA ose ligjet e vendit pritës.

10.2 Për sa nevojitet, vendi pritës do të informojë vendin dërgues dhe komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara të mbrojtjes së forcës.

10.3 Për sa nevojitet, secili vend dërgues është përgjegjës për identifikimin dhe sigurimin e kërkesave dhe kufizimeve të mbrojtjes së forcës, vendit pritës dhe komandantit të NATO-s.

10.4 Përveç përgjegjësive të mbrojtjes së forcës, të përcaktuara në politikën dhe procedurat e NATO-s, komandanti i NATO-s është përgjegjës për koordinimin e mbrojtjes së forcës të kërkuar dhe të siguruar nga vendi pritës dhe vendet dërguese aq sa nevojitet për mbrojtjen e forcës së tij.

Neni 11
Siguria dhe zbulimi i informacionit

11.1 Të gjitha informacionet e klasifikuara të shkëmbyera ose që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e stërvitjes do të përdoren, transmetohen, magazinohen, ruhen dhe do të mbrohen në përputhje me procedurat e sigurisë së NATO-s, si dhe me rregullat e ligjet e sigurisë kombëtare të vendit pritës dhe të vendeve dërguese, në masën që ato sigurojnë një shkallë jo më të rreptë se ajo që sigurohet për informacionet e klasifikuara të NATO-s të detajuara në Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut C-M (2002)49.

11.2 Informacioni i siguruar nga një pjesëmarrës ose vendi dërgues një tjetri në konfidencë dhe një informacion i prodhuar nga një pjesëmarrës ose vend dërgues për shkak të këtij memorandumi mirëkuptimi ose do të mbajë klasifikimin e tij origjinal, ose do t'i caktohet një nivel klasifikimi që do të sigurojë një shkallë mbrojtjeje kundër zbulimit të tij, i njëjtë me atë që kërkohet nga pjesëmarrësi tjetër ose vendi dërgues.

11.3 Secili pjesëmarrës do të ndërmarrë hapat ligjorë të nevojshëm për të mbrojtur nga zbulimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në konfidencë sipas këtij memorandumi mirëkuptimi, përveç kur pjesëmarrësit e miratojnë këtë zbulim.

11.4 Për të ndihmuar në sigurimin e mbrojtjes së kërkuar, secili pjesëmarrës ose vend dërgues do të shënojë informacionin e dhënë tjetrës në konfidencë, me një legjendë që tregon origjinën e tij, nivelin e klasifikimit, kushtet e përhapjes, që ky informacion ka lidhje me këtë memorandum mirëkuptimi dhe që është dhënë në konfidencë.

11.5 Informacionet dhe materialet sipas nenit 11 do të vazhdojnë të mbrohen në rast të tërheqjes nga ndonjë pjesëmarrës ose me përfundimin e memorandumit të mirëkuptimit.

11.6 Vizitat e personelit do të kryhen në përputhje me procedurat e specifikuara në C-M (2002) 49, i ndryshuar.

Neni 12
Pjesëmarrja e vendeve dërguese

Vendet dërguese që duan të marrin pjesë në stërvitjen, sipas kushteve të këtij memorandumi mirëkuptimi, do të tregojnë qëllimin e tyre me nënshkrimin nga përfaqësuesi i autorizuar i vendit dërgues, të një note pranimi dhe/ose të një deklarimi qëllimi për të marrë pjesë, në formën e përcaktuar në aneksin A të këtij memorandumi mirëkuptimi ose në forma të tjera, siç mund të pranohet bashkërisht nga vendi pritës dhe vendet dërguese.

Neni 13
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

13.1 Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit me anën e të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi. Ky memorandum mirëkuptimi do të mbetet në fuqi deri në 30 ditë pas përfundimit të stërvitjes CE 05, duke mbajtur parasysh që, për çështjet financiare të pazgjidhura dhe për ndonjë ankesë të mundshme, ky memorandum mirëkuptimi do të mbetët në fuqi deri sa këto çështje të jenë përfunduar dhe zgjidhur. Periudha e kohës, gjatë të cilit ky memorandum mirëkuptimi do të mbetet në fuqi, mund të zgjatet me pëlqim të përbashkët të pjesëmarrësve.

13.2 Dispozitat e nenit 7, 10 dhe 11 do të mbeten në fuqi në rast të tërheqjes të ndonjë pjesëmarrësi ose pas përfundimit të këtij memorandumi mirëkuptimi, me përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Vendet dërguese do të përmbushin të gjitha detyrimet në rast të ndonjë përfundimi ose tërheqjeje.

Neni 14

Ndyshimet dhe interpretimi

14.1 Ky memorandum mirëkuptimi mund të shtohet ose ndryshohet me shkrim, me pëlqim të përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve.

14.2 Ky memorandum mirëkuptimi nuk bie ndesh me ligjet e vendit pritës dhe detyrimet që rrjedhin nga traktatet. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen me negociata midis pjesëmarrësve.

14.3 Çdo konflikt për interpretimin dhe zbatimin e këtij memorandumi mirëkuptimi do të zgjidhet në konsultim mes palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk do t'i referohet për zgjidhje një gjykate kombëtare ose ndërkombëtare ose një pale të tretë për zgjidhje.

Bërë në _____, më_____2005, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe atë angleze, të dy tekstet me vlerë autentike.

Në rast të ndryshimeve në përkthim, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Sadedin Stankaj

PËR KOMANDËN SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE)
Rainer Schuwirth
General, GE A
Chief of Staff
Supreme Headquarters Allied Powers Europe

ANEKSI A I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Dokumente të zbatueshme

Dokumentet e mëposhtme do të zbatohen për qëllimet e stërvitjes në masën që ato nuk bien në kundërshtim me ligjet e vendit pritës.

a) Marrëveshja mes shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në PfP, për sa i përket statusit të forcave të tyre (PfP SOFA), bërë në Bruksel, më 19 qershor 1995;

b) Protokolli shtesë i marrëveshjes mes shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në PfP, për sa i përket statusit të forcave të tyre;

c) MC 36/2 - Ndarja e përgjegjësisë në kohë lufte midis komandantëve kombëtarë dhe komandantëve madhorë të aleancës;

d) MC 317- Struktura e forcës së NATO-s;

e) MC 319/1- Politikat dhe parimet logjistike të NATO-s;

f) MC 326/1- Politikat dhe parimet e mbështetjes mjekësore;

g) MC 334/1 - Politikat e NATO-s për MVP-në;

h) MC 336/1- Koncepti i lëvizjes dhe transportimit për NATO-n;

i) MC 400/2 - Guida e NATO-s për zbatimin ushtarak të strategjisë së aleancës;

j) STANAG-et e NATO-s dhe direktivat e zbatueshme për mbështetjen logjistike, mbrojtjen e forcës dhe rimbursimin financiar;

k) Koncepti i NATO-s për operacionet detare (CONMAROPS);

1) ALP – 9 - Doktrina e logjistikës së forcës;

m) ALP – 11- Logjistikë ndërkombëtare e Forcave Detare;

n) AJP - 4.5 (A) Publikimi i përbashkët i aleancës për doktrinat dhe procedurat e MVP-së së NATO-s;

o) ALP — 13 Doktrina e logjistikës ajrore (DRAFT);

p) AAP — 6 Përmbledhje e kushteve;

q) Guidat e planifikimit operacional (GOP);

r) C — M (2002) 49 Siguria në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut.

ANEKSI B I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Notë pranimi/deklarim qëllimi për të marrë pjesë në MVP dhe përgjegjësive financiare dhe të tjera që lindin në Republikën e Shqipërisë (vendi pritës) për stërvitjen "Cooperative engagement" 05

Qeveria e _____ (vendi pritës), përfaqësuar nga _____,

duke vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të vendosin të marrin pjesë në stërvitjen Cooperative Engagement 05;

duke konsideruar konceptin e stërvitjeve të NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s;

duke dëshiruar të marrin pjesë në rregullimet lidhur me MVP dhe përgjegjësitë financiare ose të tjera të Republikës së Shqipërisë (vendit pritës), Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe vendeve të tjera dërguese, lidhur me mbështetjen e Forcave të tyre të Armatosura gjatë stërvitjes;

zgjedhin të marrin pjesë në dhe të mbështeten nga dispozitat e parashikuara në:

Memorandumin e mirëkuptimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës, gjatë stërvitjes Cooperative Engagement 05 (MM për MVP), e cila ka hyrë në fuqi në _____, si më poshtë;

Si vend dërgues, (përshkruar në memorandum mirëkuptimi si "vendi dërgues", për planifikimin, përgatitjen (zhvillimin) e stërvitjes sipas MM të lartpërmendur. (Në rast se ka rezerva, këto do të shtohen në fjali "subjekt i rezervave të mëposhtme" dhe pas kësaj do të jepet lista e rezervave, nëse nevojitet).

Për Qeverinë e _____ (vendi dërgues)